



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ZONAVE TË MBROJTURA

Thirrje për aplikim:

- A. 2 (dy) Roje Mjedisore/Ranger assistant pranë AdZM Kukës/PNKK**
- B. 1 (një) Specialiste Projekti/Asistente Zyre pranë AdZM Dibër/PNKK**

Nga: Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM)
Adresa: Blvd.Dëshmorët e Kombit, Nr. 1, Tiranë,
www.turizmi.gov.al

Kontakte: Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM)
e-mail: Info@akzm.gov.al

Datë: 07.01.2025

Titujt vakantë:

- A. 2 (dy) Roje Mjedisore/ Ranger assistant pranë AdZM Kukës/Parku Natyror Korab-Koritnik (PNKK) për 11 muaj e 15 ditë pune (13 Janar 2025 – 31 Dhjetor 2025);
- B. 1 (një) Specialiste Projekti/Asistente Zyre pranë AdZM Dibër//Parku Natyror Korab-Koritnik (PNKK) për 11 muaj e 15 ditë pune (13 Janar 2025 – 31 Dhjetor 2025).

Referenca: Rezultati 2, Aktiviteti 2.1 (Pozicioni 1A); Rezultati 1, Aktiviteti 1.9 (Pozicioni 1B); sipas grantit të financuar nga PONT dhe zbatuar nga AKZM

1. Hyrje

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) është autoriteti qeveritar përgjegjës për menaxhimin e përgjithshëm të zonave të mbrojtura në Shqipëri. AKZM operon nëpërmjet 12 Administratave Rajonale për Zonat e Mbrojtura (AdZM), të cilat janë drejtpërdrejt përgjegjëse për menaxhimin në terren dhe monitorimin e zonave të mbrojtura, brenda territorit të rajonit të tyre. AdZM përbëhet kryesisht nga një sektor monitorimi dhe një sektor menaxhimi i mbështetur nga një numër rojesh të dedikuar për çdo zonë të mbrojtur dhe kryesisht përgjegjës për patrullimin në terren.

Prespa Ohrid Nature Trust (PONT) është një fond mirëbesimi ndërkufitar i krijuar në vitin 2015 nga Fondacioni MAVA dhe nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe

Zhvillim (BMZ) me misionin “Ruajtja e natyrës për një të ardhme të qëndrueshme përmes krijimit të partneriteteve dhe mbështetjes financiare afatgjatë”. PONT zbaton misionin e tij nëpërmjet dy programeve kryesore të granteve: (1) bashkëfinancimi i kostove operacionale të Zonave të Mbrojtura dhe (2) bashkëfinancimi i punës së Aktorëve Mjedisorë. Aktorët Mjedisorë përfshijnë organizatat jofitimprurëse (OJF) me fokus mbrojtjen e natyrës, bashkitë, institucionet shkencore dhe akademike. Për më shumë informacion ju lutemi na vizitoni në: www.pont.org.

Zbatimi i grantit 3-vjeçar është në vitin e dytë të tij (2025) dhe sipas planit operacional 2025 do të jetë për 12 muaj duke filluar nga Janar 2025. Qëllimi i grantit është bashkëfinancimi i kostove operacionale për Parkun Natyror Korab-Koritnik (PNKK) në Shqipëri në përputhje me Planin e Menaxhimit.

Kjo për të kontribuar në ruajtjen e biodiversitetit dhe përmirësimin e kushteve të jetesës të banorëve në Parkun Natyror Korab-Koritnik (PNKK).

Granti nga PONT i jepet Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM) në bashkëpunim me Agjencinë Rajonale të Zonave të Mbrojtura (AdZM) Kukës dhe Dibër me përgjegjësinë e planifikimit dhe drejtimit të zbatimit të masave të projektit në nivel vendor si dhe vendosjen e lidhjeve me aktorët lokalë.

2. Subjekti i aplikimit

Me qëllim rritjen e kapaciteteve për zbatimin e planit operacional 2025 për PN Korab-Koritnik, PONT ka dhënë një grant për AdZM Kukës dhe AdZM Dibër, nëpërmjet AKZM, duke përfshirë financimin për punësimin e personelit shtesë në AdZM Kukës dhe AdZM Dibër.

AKZM tani fton kandidatët e kualifikuar për pozicionet e mëposhtme të punës:

- A. 2 (dy) Roje Mjedisore/Ranger assistant pranë AdZM Kukës/PNKK,
- B. 1 (një) Specialiste Projekti/Asistente Zyre pranë AdZM Dibër/PNKK,

të paraqesin shprehjen e tyre të interesit dhe të dorëzojnë CV-të e tyre dhe dokumentet e tjera mbështetëse siç janë renditur më poshtë në paragrafin 3.

3. Kushtet për aplikim

- Personat e interesuar duhet të japin informacionin e tyre duke demonstruar se kanë kualifikimet e kërkuara dhe përvojën përkatëse për të kryer shërbimet sipas kërkesave të ToR-ve, përmes CV-së së tyre dhe dokumenteve të tjera mbështetëse si kopjet e diplomës; kopjet e certifikatave për kurset e trajnimit të ndjekura, studime të tjera pasuniversitare nëse ka.
- Për pozicionet e shpallura, gjuha e CV-së duhet të jetë shqip dhe CV-ja të jetë e firmosur dhe të tregojë pozicionin për të cilin aplikon kandidati.
- Afati i fundit për dorëzimin e dokumenteve të sipërpërmendura duhet të jetë brenda datës 10 Janar 2025 – ora 14.00.

- Dokumentet duhet të dorëzohen me postë të rregullt ose personalisht në AKZM: (Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Pozicioni _____. Vëmendje Oficeri i Komunikimit, Adresa: Blvd.Dëshmorët e Kombit, Nr. 1, Tiranë) ose me e-mail në adresën: info@akzm.gov.al.
- Pozicioni për të cilin kandidati po aplikon duhet të shënohet në zarf dhe në subjektin e aplikimit me email.
- Dokumentet e marra pas afatit dhe jo sipas kërkesave të mësipërme, nuk do të merren në konsideratë dhe do të përjashtohen nga konkurrimi.
- Modeli i CV-së është i disponueshëm në Aneksin 2 të kësaj ftese (Ju lutemi referojuni: Aneksit: 1A dhe 1B për Termat e Referencës (ToRs) dhe Aneksit 2 për formularin e CV-së).
- Në rast të shpalljes fitues, shërbimi do të fillojë menjëherë pas nënshkrimit të kontratës nga të gjitha palët.

Me respekt,

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura

Annex 1A
TERMAT E REFERENCES
1A. 2 (dy) Roje Mjedisore/Ranger pranë AdZM Kukës/PNKK

Autoriteti kontraktues:	AKZM/AdZM Kukës
Burimi i financimit:	Prespa Ohrid Nature Trust PONT
Referenca e buxhetit:	Rezultati 2, Aktiviteti 2.1
Detyra e ekspertit:	Roje mjedisore/ Ranger
Kohëzgjatja:	11 muaj e 15 ditë pune nga data e kontraktimit, përkohësisht 13 Janar 2025 – 31 Dhjetor 2025
Input:	Me kohë të plotë për 11 muaj e 15 ditë pune nga data e kontraktimit (13 Janar 2025 – 31 Dhjetor 2025)
Tipi i kontratës:	Kontratë shërbimi për 11 muaj e 15 ditë pune (13 Janar 2025 – 31 Dhjetor 2025)
Vendndodhja:	Punonjësi do të qëndrojë në ZM në AdZM Kukës.
Reporton tek:	Drejtori i AdZM-së. Koordinimi i përditshëm me specialistin e menaxhimit dhe monitorimit.

Hyrje:

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) është autoriteti qeveritar përgjegjës për menaxhimin e përgjithshëm të zonave të mbrojtura në Shqipëri. AKZM operon nëpërmjet 12 Administratave Rajonale për Zonat e Mbrojtura (AdZM), të cilat janë drejtpërdrejt përgjegjëse për menaxhimin në terren dhe monitorimin e zonave të mbrojtura, brenda territorit të rajonit të tyre. AdZM përbëhet kryesisht nga një sektor monitorimi dhe një sektor menaxhimi i mbështetur nga një numër rojesh të dedikuar për çdo zonë të mbrojtur dhe kryesisht përgjegjës për patrullimin në terren.

Prespa Ohrid Nature Trust (PONT) është një fond mirëbesimi ndërkufitar i krijuar në vitin 2015 nga Fondacioni MAVA dhe nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ) me misionin “Ruajtja e natyrës për një të ardhme të qëndrueshme përmes krijimit të partneriteteve dhe mbështetjes financiare afatgjatë”. PONT zbaton misionin e tij nëpërmjet dy programeve kryesore të granteve: (1) bashkëfinancimi i kostove operacionale të Zonave të Mbrojtura dhe (2) bashkëfinancimi i punës së Aktorëve Mjedisorë. Aktorët Mjedisorë përfshijnë organizatat jofitimprurëse (OJF) me fokus mbrojtjen e natyrës, bashkitë, institucionet shkencore dhe akademike. Për më shumë informacion ju lutemi na vizitoni në: www.pont.org.

Zbatimi i grantit 3-vjeçar është në vitin e dytë të tij (2025) dhe sipas planit operacional 2025 do të jetë për 12 muaj duke filluar nga Janar 2025. Qëllimi i grantit është bashkëfinancimi i kostove operacionale për Parkun Natyror Korab-Koritnik (PNKK) në Shqipëri në përputhje me Planin e Menaxhimit.

Kjo për të kontribuar në ruajtjen e biodiversitetit dhe përmirësimin e kushteve të jetesës të banorëve në Parkun Natyror Korab-Koritnik (PNKK).

Granti nga PONT i jepet Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM) në bashkëpunim me Agjencinë Rajonale të Zonave të Mbrojtura (AdZM) Kukës dhe Dibër me përgjegjësinë e planifikimit dhe drejtimit të zbatimit të masave të projektit në nivel vendor si dhe vendosjen e lidhjeve me aktorët lokalë.

Me qëllim rritjen e kapaciteteve për zbatimin e planit operacional 2025 për PN Korab-Koritnik, PONT ka dhënë një grant për AdZM Kukës dhe AdZM Dibër, nëpërmjet AKZM, duke përfshirë financimin për punësimin e personelit shtesë. AKZM po mbështet punësimin e stafit, menaxhimin dhe ngritjen e kapaciteteve të personelit të sapo punësuar.

Objektivi i punës:

AKZM dhe AdZM janë institucione të reja, prandaj mundësitë, rregullat dhe rregulloret e Zonave të Mbrojtura nuk janë gjithmonë të njohura për vizitorët dhe palët e interesuara rajonale apo lokale. Sektori i monitorimit po mbulon të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me kontrollin dhe parandalimin e aktiviteteve të paligjshme në zonat e mbrojtura, përfshirë informimin e vizitorëve. Roje mjedisore/ Ranger siguron që palët e interesuara rajonale dhe vizitorët të respektojnë rregullat në park. Përveç kësaj, rojtari ofron mbështetje teknike për kërkimin, monitorimin, mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe informacionin e vizitorëve.

Roje mjedisore/ Ranger do të punojë ngushtë me drejtorin e AdZM-së dhe stafin e tij, domethënë rojet e tjerë dhe do t'i raportojë drejtorit. Koordinimi i përditshëm dhe mbikëqyrja teknike është me Përgjegjësin e Sektorit të Monitorimit të AdZM-së.

Përmbledhja e detyrave specifike të një Ranger sipas Rregullores së Brendshme për Organizimin dhe funksionimin e AKZM-së dhe AdZM-së:

- Mbikqyr zbatimin e ligjeve dhe akteve të tjera ligjore për mbrojtjen dhe menaxhimin e burimeve natyrore, biodiversitetit të zonës së mbrojtur.
- Kontrollon dhe patrullon të gjitha aktivitetet dhe shërbimet brenda territorit të zonës së mbrojtur.
- Kontrollon zbatimin e planit të menaxhimit të zonës së mbrojtur dhe (brenda kufizimeve të kompetencave ligjore që i besohen këtij pozicioni) merr masa në rast të shkeljes së objektivave të menaxhimit ose mosrespektimit të aktiviteteve të parashikuara.
- Mbron mjedisin nga dëmtimet, zjarri, insektet dhe sëmundjet, ndotja mjedisore, erozioni i tokës dhe ujit, burimet e rëndësishme gjenetike (bimët dhe kafshët), kontrolli i përdorimit të tyre, gjuetia dhe peshkimi.
- Kontrollon zbatimin e rregullave që dalin nga konventat, direktivat, marrëveshjet, projektet dhe programet nën administrimin dhe menaxhimin e zonës së mbrojtur.
- Kontrollon zbatimin e kritereve për ruajtjen dhe rehabilitimin e specieve dhe habitateve të rëndësishme, mbrojtjen e bimësisë, kafshëve të egra dhe veçorive të tjera natyrore kundër dëmtimit ose shkatërrimit si dhe zbatimin e teknikave të menaxhimit ekologjik.

- Kontrollon zhvillimin e aktiviteteve ekonomike në përputhje me menaxhimin e territorit të zonës së mbrojtur.
- Vëzhgon zbatimin e aktiviteteve me leje mjedisore, veçanërisht projektet infrastrukturore dhe vigjilent për ndërtimet pa leje në territorin e zonës së mbrojtur.
- Parandalon, zbulon dhe lufton me anë të raportimit në strukturat përkatëse në AdZM dhe AKZM, dëmtimin, zaptimin, abuzimin, shkatërrimin e mjedisit tokësor dhe ujor, gjuetinë dhe peshkimin me metoda të paligjshme, dëmtimin e pyjeve dhe çdo aktivitet tjetër joligjor.
- Verifikon, evidenton, raporton e njofton tek strukturat përkatëse në AdZM (Drejtorin e AdZM ose Shefin e Sektorit të Shërbimit të Monitorimit) dhe AKZM për bllokimin ose konfiskimin e veprimtarisë së çdo personi juridik që nuk paguan detyrimet/tarifat ligjore në fushën përkatëse të veprimtarisë së tij ose të çdo mjeti të paligjshëm që përdoret në peshkim apo gjueti.
- Koordinon për detyra specifike teknike me institucionet e tjera aktive në zonën e mbrojtur.
- Përgjegjës për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e pajisjeve dhe mjeteve që janë në dispozicion për realizimin e punëve dhe detyrave, ofron mbështetje teknike për mirëmbajtjen e infrastrukturës përmes monitorimit të gjendjes së tyre.
- Kryen punime të vogla riparimi.
- Mbështet informimin e vizitorëve në terren, përmes shpërndarjes së fletëpalosjeve dhe materialeve të tjera informative dhe merr pjesë në ngjarjet lokale/aktivitetet edukative të organizuara.
- Ofron mbështetje teknike për aktivitetet kërkimore dhe monitoruese të rregullta të Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura siç caktohet nga Përgjegjësi i Sektorit/Drejtori.
- Dokumenton problemet, detyrat e kryera, procesverbalet, mjetet e sekuestruara etj., në një libër shërbimi.

Kryen detyra të tjera në përputhje me funksionin e pozicionit të tij në koordinim të ngushtë me Drejtorin e AdZM-së dhe Shefin e Sektorit të Shërbimit të Monitorimit.

Në vijim të Planit Operacional Vjetor të AdZM-së, me marrjen e detyrës do të hartohet një listë e detyrave të detajuara për 11 muaj e 15 ditë pune të vitit 2025 dhe një plan mujor personal i punës, i cili do të miratohet nga mbikëqyrësi – Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimit të Monitorimit.

Kërkesa të përgjithshme:

- Demonstron integritet duke promovuar vlerat dhe standardet etike të AKZM-së.
- Shfaq ndjeshmërinë dhe përshtatshmërinë e kulturës, gjinisë, fesë, racës, kombësisë dhe moshës.
- Aftësi në organizimin dhe kryerjen me saktësi të detyrave të shumta, duke vendosur prioritete dhe duke marrë në konsideratë detyra të veçanta, ndërprerje të shpeshta, afate, burime të disponueshme dhe raportime të shumëfishta.
- Aftësi për të planifikuar, koordinuar dhe organizuar ngarkesën e punës, duke qenë të vetëdijshëm për ndryshimin e prioriteteve dhe afatet kohore.

- Përvojë në krijimin, ndërtimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve efektive të punës me stafin, vizitorët, komunitetin lokal dhe palët e tjera të interesuara.
- Aftësi për të identifikuar mundësi për ngritjen e kapacitetit të stafit.
- Ndjeshmëri dhe përgjegjshmëri ndaj të gjithë stafit dhe bashkëpunëtorëve.
- Aftësi për të mbështetur zbatimin e aktiviteteve, qasjeve dhe ideve të reja dhe për të ndikuar në ndryshimin e sjelljes/qëndrimit të stafit.
- Ndjek mundësitë e zhvillimit profesional të ofruara në kuadër të grantit PONT për Parkun Natyror Korab-Koritnik (PNKK).

Aftësi vetë-menaxhuese:

- I fokusuar në rezultat për AKZM-në / AdZM-në.
- I qaset vazhdimisht punës me energji dhe qëndrim pozitiv e konstruktiv.
- Leadership dhe motivues.
- Mbetet i qetë, në kontroll dhe me humor të mirë edhe nën presion.
- Demonstron hapje ndaj ndryshimeve dhe aftësi për të menaxhuar kompleksitetet.
- Përgjigjet pozitivisht ndaj reagimeve kritike dhe këndvështrimeve të ndryshme.
- Kërkon komente nga stafi për ndikimin e sjelljes së tij/saj.

Kualifikimet:

- Minimumi diplomë të shkollës 8-vjeçare ose të mesme, kualifikime të tjera, p.sh. çertifikatë profesionale ose bachelor (ka prioritet).
- Njohja e mirë e gjuhës shqipe (me shkrim dhe me gojë), anglishtja apo gjuhë të tjera të huaja kanë përparësi.
- Fizikisht i aftë dhe i gatshëm për punë fizike.
- I apasionuar mbas aktiviteteve në natyrë, duke marrë parasysh kushtet klimaterike.
- Aftësi të mira komunikimi dhe bashkëpunimi në grup.
- Aftësi praktike, p.sh. në rregullimin e pajisjeve teknike, mirëmbajtjen e automjeteve, etj.
- I interesuar për të punuar në Parkun Natyror Korab-Koritnik (PNKK), eksperiencë të mëparshme si roje mjedisore/ranger ose në administrimin e zonave të mbrojtura përbën prioritet.
- Do të përzgjidhen vetëm personat që jetojnë, kanë lidhje me zonën ose janë me origjinë nga Parku Natyror Korab-Koritnik (PNKK).
- Të gatshëm për të punuar edhe jashtë orarit zyrtar të punës.

Aneksi 1B TERMAT E REFERENCËS

1B. 1 (një) Specialiste Projekti/Asistente Zyre pranë AdZM Dibër/PN Korab-Koritnik

Autoriteti kontraktues:	AKZM/AdZM Dibër
Burimi i financimit:	Prespa Ohrid Nature Trust PONT
Referenca e buxhetit:	Rezultati 1, Aktiviteti 1.9
Detyra e ekspertit:	Specialiste Projekti/Asistente Zyre për AdZM Dibër /PN Korab-Koritnik
Kohëzgjatja:	11 muaj e 15 ditë pune nga data e kontraktimit, përkohësisht 13 Janar 2025 – 31 Dhjetor 2025
Input:	Me kohë të plotë për 11 muaj e 15 ditë pune nga data e kontraktimit (13 Janar 2025 – 31 Dhjetor 2025).
Tipi i kontratës:	Kontratë shërbimi 11 muaj e 15 ditë pune (13 Janar 2025 – 31 Dhjetor 2025)
Vendndodhja:	Eksperti do të qëndrojë në ambientet e AdZM në Dibër /PN Korab-Koritnik.
Reporton tek:	Drejtori i AdZM, AKZM dhe Shefi i Sektorit të Projekteve. Koordinimi i përditshëm me drejtorin e AdZM dhe shefin e menaxhimit.

Hyrje:

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) është autoriteti qeveritar përgjegjës për menaxhimin e përgjithshëm të zonave të mbrojtura në Shqipëri. AKZM operon nëpërmjet 12 Administratave Rajonale për Zonat e Mbrojtura (AdZM), të cilat janë drejtpërdrejt përgjegjëse për menaxhimin në terren dhe monitorimin e zonave të mbrojtura brenda territorit të rajonit të tyre. AdZM përbëhet kryesisht nga një sektor monitorimi dhe një sektor menaxhimi i mbështetur nga një numër rojesh të dedikuar për çdo zonë të mbrojtur dhe kryesisht përgjegjës për patrullimin në terren.

Prespa Ohrid Nature Trust (PONT) është një fond mirëbesimi ndërkufitar i krijuar në vitin 2015 nga Fondacioni MAVA dhe nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ) me misionin “Ruajtja e natyrës për një të ardhme të qëndrueshme përmes krijimit të partneriteteve dhe mbështetjes financiare afatgjatë”. PONT zbaton misionin e tij nëpërmjet dy programeve kryesore të granteve: (1) bashkëfinancimi i kostove operacionale të Zonave të Mbrojtura dhe (2) bashkëfinancimi i punës së Aktorëve Mjedisorë. Aktorët Mjedisorë përfshijnë organizatat jofitimprurëse (OJF) me fokus mbrojtjen e natyrës, bashkitë, institucionet shkencore dhe akademike. Për më shumë informacion ju lutemi na vizitoni në: www.pont.org.

Zbatimi i grantit 3-vjeçar është në vitin e dytë të tij (2025) dhe sipas planit operacional 2025 do të jetë për 12 muaj duke filluar nga Janar 2025. Qëllimi i grantit është bashkëfinancimi i kostove operacionale për Parkun Natyror Korab-Koritnik (PNKK) në Shqipëri në përputhje me Planin e Menaxhimit.

Kjo për të kontribuar në ruajtjen e biodiversitetit dhe përmirësimin e kushteve të jetesës të banorëve në Parkun Natyror Korab-Koritnik (PNKK).

Granti nga PONT i jepet Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM) në bashkëpunim me Agjencinë Rajonale të Zonave të Mbrojtura (AdZM) në Kukës dhe Dibër me përgjegjësinë e planifikimit dhe drejtimit të zbatimit të masave të projektit në nivel vendor si dhe vendosjen e lidhjeve me aktorët lokalë.

Me qëllim rritjen e kapaciteteve për zbatimin e planit operacional 2025 për PN Korab-Koritnik, PONT ka dhënë një grant për AdZM Kukës dhe AdZM Dibër, nëpërmjet AKZM, duke përfshirë financimin për punësimin e personelit shtesë. AKZM po mbështet punësimin e stafit, menaxhimin dhe ngritjen e kapaciteteve të personelit të sapo punësuar.

Objektivi i punës:

Sipas strukturës aktuale organizative dhe rregulloreve funksionale të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, të gjitha aktivitetet në lidhje me menaxhimin e projekteve, menaxhimin financiar dhe burimet njerëzore janë trajtuar në nivelin qendror. Sidoqoftë, duke marrë parasysh që të gjitha aktivitetet ndodhin në nivelin rajonal është e nevojshme që të sigurohet mbështetje dhe ndihmë për AdZM për t'u marrë me këto çështje, për këtë qëllim një Specialist Projektsh/Asistente zyre po vendoset në AdZM Dibër me financim nga PONT.

Nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të Drejtorit të Përgjithshëm të AKZM-së, Drejtorit të AdZM-së, dhe Shefit të Sektorit të Financave, specialisti do t'i sigurojë mbështetje AdZM-së në raportimin teknik, hartimin e dokumenteve teknike (raportet, ToR, BoQ), monitorimin e progresit të projektit, sigurimin e të dhënave për procesin e planifikimit vjetor në zhvillimin e planeve dhe programeve të lidhura me buxhetin si dhe çështje të tjera që lidhen me zbatimin pa probleme të projektit në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe kërkesat e PONT. Gjithashtu do të sigurojë informacion të azhurnuar për AKZM-në ose / dhe donatorë të tjerë për çështje të lidhura me financimin.

Specialisti do të ndihmojë në mbajtjen e komunikimit të vazhdueshëm me Drejtorinë e Financave dhe Shërbimeve të Brendshme në AKZM dhe do të mbështesë shkëmbimin e informacionit në lidhje me hartimin e buxhetit. Specialisti do të sigurojë mbështetje për AdZM-në në çështje që lidhen me menaxhimin e burimeve njerëzore, si dhe çështje të tjera të AdZM-së në lidhje me kërkesat administrative në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe kërkesat e PONT.

Pozicioni me kohë të plotë i vendosur pranë AdZM është i njëjtë me ato të një specialisti Projektsh/Asistente zyre të AKZM-së sipas Rregullores së Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e AKZM-së dhe AdZM-së.

Detyrat specifike:

Për sa i përket mbështetjes për AdZM Dibër, përgjegjësitë e Specialist Projekti/Asistente zyre përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në detyrat e mëposhtme:

- Kontribuon teknikisht në planifikimin, zbatimin dhe raportimin e planeve të punës vjetore dhe mujore të AdZM, duke përfshirë planifikimin e burimeve (staf dhe buxhet) për aktivitetet e parashikuara, në përgjithësi dhe në veçanti duke ofruar të dhëna për dokumente teknike (raporte, ToR, BoQ), duke komentuar mbi rezultatet e arritura dhe duke u dhënë prioritet aktiviteteve të projektit.
- Në bashkëpunim me Sektorin e Financave mbështet raportimin financiar periodik në përputhje me kërkesat e AKZM dhe PONT.
- Merr pjesë në takime të AKZM në lidhje me zbatimin e grantit dhe veçanërisht në:
 - Zbatimin e planeve të punës vjetore dhe mujore të AdZM-së.
 - Kontribuon në parashikimin e kostove dhe buxhetin sipas aktiviteteve të parashikuara në planet vjetore të AdZM-së. Mbështet parashikimin e e buxhetit të kërkuar për zbatimin e planit operacional vjetor.
 - Mbështet raportimin mujor të AdZM-së në përputhje me kërkesat e AKZM-së dhe donatorëve (transferimi mujor i dokumenteve përkatëse financiare dhe kontraktuale, përgatitja mujore e fletëve të kohës së punës (Timesheet/TS), kontabiliteti mujor dhe menaxhimi financiar, raportimi në përputhje me kërkesat e PONT-it).
 - Mbështet aktivitetet e tjera financiare / administruese të AdZM-së (p.sh. sistem regjistrimi efektiv, monitorimi dhe raportimi i aktiviteteve të prokurimit).
 - Sipas kërkesës, mbështet për krijimin e një sistemi të ndihmës për zyra, burime njerëzore dhe logjistike për AdZM-në.
 - Mbështet në organizimin dhe kryerjen e vlerësimeve të rregullta (vjetore) të METT për PNKK, duke marrë parasysh raportet vjetore.
 - Mbështet përgatitjen e raporteve të ndërmjetme dhe përfundimtare për zbatimin e marrëveshjes së grantit me PONT, duke kontribuar në dokumentimin financiar dhe Teknik të aktiviteteve dhe hartimin e rekomandimeve për përshtatjen e menaxhimit të projektit.

Kryen çdo detyrë tjetër në përputhje me funksionin e pozicionit në koordinim të ngushtë me Drejtorin e AKZM-së dhe AdZM-së dhe Sektorin e Financave të AKZM-së.

Sipas detyrave të AKZM-së dhe Planit Vjetor Operacional 2025 të AdZM-së, me marrjen e detyrës do të hartohet një listë me detyra të hollësishme për 12 muajt e 2025 dhe një plan personal mujor i punës, i cili do të miratohet nga Drejtori i AdZM-së.

Kërkesa të përgjithshme:

- Demonstron integritet, duke promovuar vlerat dhe standardet etike të AKZM-së.
- Paraqet ndjeshmëri dhe përshtatje kulturore, gjinore, fetare, racore, të kombësisë dhe moshës.

- Aftësi për të organizuar dhe kryer me saktësi detyra të shumta, duke vendosur prioritete duke marrë në konsideratë detyra të veçanta, ndërprerje të shpeshta, afate, burime të disponueshme dhe marrëdhënie të shumta raportimi.
- Aftësi për të planifikuar, koordinuar dhe organizuar ngarkesën e punës, ndërsa mbetet i vetëdijshëm për ndryshimin e përparësive dhe afateve.
- Përvojë në krijimin, ndërtimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve efektive të punës me stafin, vizitorët, komunitetin lokal dhe palët e tjera të interesuara për të lehtësuar ofrimin e mbështetjes.
- Aftësi për të identifikuar mundësitë e ngritjes së kapaciteteve për stafin.
- Ndjeshmëri dhe përgjegjshmëri ndaj të gjithë stafit dhe palëve të tjera të interesuara.
- Aftësi për të mbështetur zbatimin e aktiviteteve, qasjeve dhe ideve të reja dhe për të ndikuar në ndryshimin e sjelljes/qëndrimit të stafit.
- Ndjekja e mundësive të zhvillimit profesional, të ofruara në kuadrin e mbështetjes së projektit PONT, d.m.th. trajnime për vendin e punës, masa për ndërtimin e kapaciteteve etj.

Aftësi vetë-menaxhuese:

- I fokusuar në rezultat për AKZM-në / AdZM-në.
- I qaset vazhdimisht punës me energji dhe qëndrim pozitiv e konstruktiv.
- Leadership dhe motivues.
- Mbetet i qetë, në kontroll dhe me humor të mirë edhe nën presion.
- Demonstron hapje ndaj ndryshimeve dhe aftësi për të menaxhuar kompleksitetet.
- Përgjigjet pozitivisht ndaj reagimeve kritike dhe këndvështrimeve të ndryshme.
- Kërkon komente nga stafi për ndikimin e sjelljes së tij/saj.

Kualifikimet:

- Minimumi diplomë universitare Bachelor, avantazh kanë kandidatët me: Master Universitar në Administrim Biznesi, Ekonomik, Juridik, ose fusha të ngjashme me pozicionin e punës të ofruar.
- Përvojë e mëparshme në fushën e menaxhimit të projekteve përbën prioritet.
- Njohuri të mira të gjuhës angleze (me shkrim dhe me gojë).
- Njohuri të mira të programeve windows (word, Excel, PowerPoint dhe Microsoft Outlook) dhe për të përdorur internetin. Përvoja e mëparshme e punës në lidhje me detyrat financiare, administrative, sekretariale.
- Aftësi të shkëlqyera ndërmjerrëzore dhe komunikuese.
- Aftësia për të punuar në mënyrë proactive.
- Aftësia për të operuar në një mjedis ndërkulturor që kërkon fleksibilitet. Sjellje dhe pamje profesionale.
- Do të përzgjidhen vetëm personat që jetojnë, kanë lidhje me zonën ose janë me origjinë nga Parku Natyror Korab-Koritnik (PNKK).
- Shumë i organizuar dhe i aftë të punojë mirë në një ekip.

Aneksi 2 CV form

Pozicioni: *Shënoni pozicionin për të cilin aplikoni*

CURRICULUM VITAE

- 1. Mbiemri:** xxx
2. Emri: xx
3. Ditëlindja: xx
4. Kombësia: xx
5. Gjendja civile: xx
6. E-mail: xx
7. Celular: xx
8. Edukimi:

Data (nga – deri)	Institucioni	Diplomat:
Xxx	X	X
Xxx	X	X
Xx	X	x

9. Aftësitë në gjuhët e huaja: Vlerësoni nivelin nga 1 deri në 5 (5 – shkëlqyeshëm; 1 – bazë)

Gjuha	Të lexuarit	Të folurit	Të shkruarit
X	Gjuha amtare		
X			
X			
X			

10. Anëtarësimi në grupe profesionale: / xxx

11. Aftësi të tjera: xxx

12. Pozicioni aktual: xxx

13. Vite në këtë pozicion: x years

14. Aftësi kyçe:

- *Përshkruani në detaje*

15. Eksperienca specifike në rajon:

Shteti	Data nga – deri
XXX	Muaji/Viti

16. Eksperienca profesionale

Data nga – deri	Vendi	Kompania	Pozicioni	Përshkrimi
xxx - aktualisht	xx	xx	x	<i>Përshkruani me detaje</i>
xxx - xxxx				•
xxx – xxxx				•
xxx – xxxxx				•
xxx - xxx				•

17. Informacione të tjera:

Data	Titulli i trajnimit/workshopit	Vendi, institucioni
Xxx	Xxx	xxx
Xxx	Xxx	xxx
Xxx	Xxx	xxx
Xxx	Xxx	
Xxx	Xxx	
Xxx	Xxx	

18. Publikime:

Autori (Viti)– Titulli, Gazeta/shtëpia botuese